

# JOFTIMI VJETOR PER SHERBIMET E NXENESVE ME AFTESI TE KUFIZUAR PERFSHIRE EDUKIMIN SPECIAL DHE MASAT MBROJTESE PER NXENESIT ME PAAFTESI

Drejtoria Arsimore e Filadelfias dhe Njësia Ndërmjetëse e Filadelfias (Philadelphia Intermediate Unit) (IU26) ofrojnë shërbime që lidhen me edukimin special, për fëmijët rezidentë, që janë me paaftësi, të moshës nga tre deri njëzet e një vjeç. Qëllimi i këtij njoftimi është të përshkruaj (1) llojin e paaftësisë, që shërben për kualifikimin e fëmijëve në këto programe dhe shërbime, (2) programet dhe shërbimet përkatëse që janë të vlefshme, (3) procesin nëpërmjet të cilave shkollat publike bëjnë kontrollin dhe vlerësimet për këta nxënës dhe (4) të drejtat e veçanta që përfitojnë këta nxënës dhe prindërit, ose kujdestarët e tyre ligjorë.

## FËMIJËT TË CILËVE U AKORDOHEN PROGRAME TË EDUKIMIT SPECIAL

Shërbimet e edukimit special, ofrohen për fëmijët, të cilët kanë së paku një prej paaftësive fizike, ose mendore si më poshtë:

- autizëm/autism
- shurdh/qorr/deaf/blindness
- shqetësime emocionale/ emotional disturbance
- dëmtim të dëgjimit, përfshirë shurdhimin/hearing impairment, including deafness
- vonesë të zhvillimit mendor/mental retardation
- paaftësi të shumëfishta/multiple disabilities
- dëmtime ortopedike/orthopedic impairment
- dëmtime të tjera të shëndetit/other health impairment
- paaftësi specifike për të mësuar/specific learning disability
- paaftësi gjuhësore, ose të të folurit/speech or language impairment
- dëmtime të trurit/traumatic brain injury; dhe
- dëmtim të shikimit, përfshirë verbërinë/and visual impairment, including blindness
- vonesa të zhvillimit (në rastet e fëmijës në parashkollor) /developmental delay (in the case of a pre- school child)

## PËRSHKRIMI I PROGRAMEVE TË EDUKIMIT SPECIAL

Shkollat Publike/IU26 ofrojnë programet e duhura të edukimit special dhe shërbimet përkatëse, të cilat janë:

- ofrohen falas, pa shpenzime nga prindërit;
- ofrohen nën autoritetin e shkollës, njesisë, drejtpërsëdrejtë, me referencë, ose me kontratë;
- individualizohen në përshatje me nevojat e fëmijës;
- planifikohen në mënyrë të tillë, që të ketë përfitime dhe progres të arsyeshëm dhe përpilohen për një qasje të drejtë me Programin Mësimor Individual.

Edukimi special është projektuar për nevojat e veçanta secilit fëmijë, përfshirë mësimet të veçanta që zhvillohen në klasë, në shtëpi, në mjedise të përbashkëta, në spital, në institucione dhe mjedise të tjera.

Shërbimet përkatëse të vlefshme për nxënësit përfshijnë transportin, shërbimet mbështetëse, të cilat e ndihmojnë nxënësin e paaftë, të përfitojë prej edukimit special. Shëmbujt përfshijnë: patologjia e të folurit dhe audiologjia, shërbimet psikologjike, terapi fizike dhe profesionale, shërbime të punës sociale, shërbime shëndetësore në shkollë, shërbime mjekësore për diagnostifikimin dhe vlerësimin, edukimin dhe këshillimin prindëror, shërbime këshillimi për rikuperim, shërbime këshillimi për rehabilitim dhe shërbime ndihmuese në teknologji.

## REFERIMI I FËMIJËS PËR KONTROLL DHE VLERËSIM

Shkollat Publike/IU26 kanë procedurë për identifikimin e fëmijëve që kanë nevojat për edukim special. Këto procedura janë "kontrolli" dhe "vlerësimi." Në rastet që ka dyshime për paaftësi, mësuesi, personeli tjetër i shkollës, ose prindërit mund të referojnë një fëmijë për kontroll dhe/ose vlerësim. Prindërit që dyshojnë se fëmija ka paaftësi mund të kërkojnë program edukimi të veçantë, mund të kërkojnë për kontroll, ose vlerësim në çdo kohë, duke kontaktuar drejtorin e shkollës së tyre. Aktiviteti i kontrollit përfshin: rishikimin e menjëhershëm të të dhënave egzistuese, të tilla si, rekordet e shëndetit, intervistë me prindin dhe historinë e sëmundjes; vlerësimet e funksioneve të shikimit dhe dëgjimit; përcaktimin e përgjigjes së nxënësit që tenton rehabilitimin; si edhe, në rastet që kërkohen nga prindërit, kontrolli për të folurim dhe gjuhën. Nëse pas kontrollit dalin rekomandime për vlerësim, ekipi i vlerësimit do t'i realizojë ato. Nuk mundet të kryhen vlerësime pa lejen me shkrim të prindit. Për më tepër informacion konsultohuni me këshilltarin e shkollës tuaj.

Ligjet e Shtetit dhe ato Federale ofrojnë shumë të drejta dhe mbrojtje për fëmijët me paaftësi dhe prindërit e tyre. Më poshtë janë një përmbledhje e këtyre të drejtave dhe mbrojtjeve. Personat e interesuar mund të marrin një përmbledhje të tillë, bashkë me informacionin për shërbime ligjore dhe këshilla juridike falas, ose me kosto të ulët duke kontaktuar koordinatoren e edukimit special, ose drejtorin e shkollës publike lokale.

## Ë DREJTAT DHE MBROJTJA

**NJOFTIM PARAPRAK ME SHKRIM:** Shkolla publike duhet t'ju njoftojë me shkrim në të gjitha rastet kur propozohet të fillojë, ose të ndryshojë identifikimin, vlerësimin, programin mësimor, ose vendosja e fëmijës, ose kurdoherë që refuzohet të bëhen ndryshime në identifikim, në vlerësim, në programin mësimor, ose vendosjen e kërkuar prej prindit. Njoftimet e tilla duhet të shoqërohen me një përshkrim të detajuar të arsyeve për propozimin, ose refuzimin, opsionet që do të merren në konsideratë, në rast se ka të tilla, dhe arsyet pse këto opsione janë refuzuar.

**MIRATIMI:** Shkolla publike nuk mund të procedojë me një vlerësim, ose me një dispozitë fillestare për edukimin special dhe shërbime që lidhen me ato, pa miratimin me shkrim të prindit.

Translation and Interpretation Center (11/2018)

Shkolla publike nuk mund të kërkojë një seancë dëgjimore që të hedhë poshtë refuzimin e bërë prej prindit, për një vendosje të fëmijës në edukimin special. Shkolla publike mund të kalojë mbi mos miratimin e prindit për një vlerësim fillestar, duke kërkuar një seancë të paanëshme dëgjimore. Në rast se prindi nuk i përgjigjet kërkesës me shkrim për leje vlerësimi, atëherë shkolla mund të vazhdojë rivlerësimin e propozuar, edhe pa miratimin e prindit.

**MBROJTA NË PROCEDURËN E VLERËSIMIT:** Vlerësimet për gjendjen dhe nevojat e veçanta të edukimit special dhe shërbimet që lidhen me ato, duhet të administrohen pa dallime raciale, kulturore, ose gjuhësore. Vlerësimet nuk mund të konsistojnë në teste, ose vlerësime të veçanta dhe testimi dhuhet të jetë një masë e vlefshme për vlerësimin psikologjik, social, emocional, ose të karakteristikave të tjera mësimore ose të sjelljes, të cilat përdoren nga shkolla si masa vlerësimi. Testimi dhe vlerësimi duhet të administrohen në përshatje me standardet profesionale dhe kritere të përcaktuar. Ato duhet të administrohen në gjuhën amtare të fëmijës.

**FSHEHTËSIA:** Rekordet dhe dokumentat që janë pjesë e procesit të kontrollit dhe vlerësimit, janë të fshehta (konfidenciale) dhe mbrohen nga Akti për të Drejtat Mësimore të Familjes dhe Privatësinë (FERPA). Drejtoria Arsimore, njësitet e ndërmjetëse dhe shkollat charter, mbajnë të dhënat që lidhen me fëmijët, përfshirë edhe ata me paaftësi. Të gjitha të dhënat mbahen në fshehtësi shumë rigoroze. Miratimi juaj, ose miratimi i një fëmije që ka arritur moshën madhore për dhënie e pëlqimit, sipas ligjit të Shtetit, duhet të merret përpara se të jepet informacioni për identifikimin personal, përveç rasteve kur lejohet nga FERPA. Moshë madhore në Pensilvani është 21 vjeç. Cilado agjensi pjesëmarrëse duhet të mbrojë fshehtësinë e informacionit identifikues, në të gjitha fazat, në atë të mbledhjes së informacionit, ruajtjes, dhënies dhe asgjësimit të tij. Në secilën agjensi pjesëmarrëse duhet të ketë një person që ka përgjegjësinë e ruajtjes së fshehtësisë të identifikimit të personave. Cilado agjensi pjesëmarrëse duhet të mbajë për publikun listën e personave dhe pozicionit të punonjësve, që kanë akses në informacionet personale. Për më tepër informacion që lidhet me rekordet e fëmijëve, prindi mund të referohet te FERPA. Ky njoftim është vetëm një përmbledhje e shërbimeve të Edukimit Special, aktiviteteve të kontrollit dhe vlerësimit, të drejtave dhe mbrojtjes që ju garantohet fëmijëve me paaftësi, fëmijëveqë supozohet të jenë të paaftë dhe prindërit e tyre. Për më tepër informacion, ose për të kërkuar kontroll, ose vlerësim të një fëmije në shkollë publike, ose private, kontaktoni në listën më poshtë. Për fëmijët në moshën parashkollore (moshat 3-5vjeç), informacioni, kërkesat për kontroll dhe vlerësim, mund të kryhen duke kontaktuar **Elwyn SEEDS** në numrin 215-222-8054.

## MË SHUMË INFORMACION

Një informacion i detajuar për programet dhe shërbimet speciale dhe politikave të Philadelphia/IU26, mund të merret me kërkesën tuaj në School District/IU26. Kushdo që është i interesuar duhet të kontaktojë drejtorin e shkollës të fëmijës. Informacioni dhe komunikimi janë në gjuhën Angleze, por në përshatje me gjuhën amtare të prindit mund të ofrohet shërbim në atë gjuhë me përkthyes. Më tepër informacion mund të gjendet në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias:

<https://www.philasd.org/specializedservices/>

## **Zyra e Shërbimeve të Specializuara (Office of Specialized Services) (OSS)**

### **Office of Specialized Services (OSS)**

440 N. Broad Street, 2nd Fl. | Phila., PA 19130 | P: 215-400-4170 | Parent #: 267-784-9274

### **Charter, Partnership, and New School Office**

Email: [charters@philasd.org](mailto:charters@philasd.org) | Main office phone: 215-400-4090

### **Learning Network 1**

South Phila. High | 2101 S. Broad Street, Phila., PA 19148 | P: 215-400-5043

### **Learning Network 2**

Middle Years School | 4725 Fairmount Ave., Phila., PA 19139 | P: 215-400-5043

### **Learning Network 3**

440 N. Broad Street, Phila., PA 19130 | Suite 210 | P: 215-400-6147

### **Learning Network 4**

440 N. Broad Street, Phila., PA 19130 | Suite 210 | P: 215-400-6147

### **Learning Network 5**

Rivera Building | 2603 N. 5th Street, 5th floor, Phila., PA 19133 | P: 215-400-8050

### **Learning Network 6**

Hill-Freedman | 1100 E. Mt. Pleasant Ave., Phila., PA 19150 | P: 215-400-8052

### **Learning Network 7**

Grover Washington M.S. | 201 E. Olney Ave., Phila., PA 19120 | P: 215-400-8054

### **Learning Network 8**

4101 Chalfont Drive, Phila., PA 19154 | P: 215-400-8056

### **Learning Network 9**

Lincoln High | 3201 Ryan Ave., Phila., PA 19136 | Suite 206 | P: 215-400-5289

### **Learning Network 10**

Catherine Annex | 6900 Greenway Ave., 3<sup>rd</sup> Floor, Phila., PA 19143 | P: 215-400-6113

### **Learning Network 11**

Rivera Building | 2603 N. 5th Street, 5th floor, Phila., PA 19133 | P: 215-400-6113

### **Learning Network 12**

Catherine Annex | 6900 Greenway Ave., 5<sup>th</sup> Floor, Phila., PA 19143 | P: 215-400-5361

### **Learning Network 13**

440 N. Broad Street, Phila., PA 19130 | Suite 210 | P: 215-400-5361

### **Acceleration Network**

McMichael School | 3543 Fairmount Ave., Phila., PA 19104 | P: 215-400-5289

### **Innovation Network**

440 N. Broad Street, Phila., PA 19130 | P: 215-400-6792

### **Opportunity Network**

440 N. Broad Street, Phila., PA 19130 | P: 215-400-6385